



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1092 Prot.

Gjirokaštër, më 21 . 08. 2019

**Lënda:** Përcillet vendimi i Bordit të Administrimit për kriteret e procedurës së përzgjedhjes së Administratorit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaštër.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", PROF.DR.BEKTASH MEMA.**

**KËTU**

**KRYETAR**

**Dr. Merita Isaraj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”  
GJIROKASTËR  
BORDI I ADMINISTRIMIT

**VENDIM NR. 51**

Bordi i Administrimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, në mbështetje të Nenit 51 pika 4 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit Nr. 10, datë 03/05/2017 me nr. 453 prot; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.08.2019,

**V E N D O S I:**

**Të shpallë konkursin për Administrator të institucionit si më poshtë:**

**I. Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:**

**A. KRITERE SKUALIFIKUESE**

1. Të ketë diplomë “Master i Shkencave“ ose ekuivalent me të në fushën e drejtësisë ose ekonomisë, brenda ose jashtë vendit (të ekuivalentuara në M.A.S.).
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 7 vjet në fushat e mësipërme;
3. Të ketë dëshmi penaliteti të pastër dhe të mos përfshihet në rastet e Ligjit Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**Shënim:** Mosplotësimi i një prej kriterëve të mësipërme, përbën shkak për skualifikim nga kandidaturat që do t’i përcillen Bordit të Administrimit nga Senati Akademik.

**B. KRITERE PREFERUESE**

1. Për kandidatët, nota mesatare e studimeve për secilin cikël në rastin e studimeve të përfunduara sipas sistemit të Bolonjës, (diplomat “Bachelor“ dhe “Master i Shkencave“) dhe për diplomat 4 vjeçare të mëparshme, të jetë jo më pak se 8;
2. Të ketë njohje të mirë të gjuhës angleze sipas testeve ndërkombëtare të njohura nga M.A.S. në Udhëzimin Nr. 52, datë 3.12.2015, të ndryshuar;

3. Kandidatët të dorëzojnë një platforme të zhvillimit institucional me prioritetet, objektivat dhe mjetet e realizimit të tyre;
4. Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi nga institucionet ku ka ushtruar ose ushtron funksione, si dhe të mos jetë larguar nga puna e mëparshme për shkaqe disiplinore;
5. Rekomandim nga punëdhënësi i fundit mbi performancën e kandidatit;
6. Kandidati duhet të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punojë në grup;
7. Të ketë njohuri mbi Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin e arsimit të lartë, legjislacionin mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin, konfliktin e interesave, prokurimet publike, procedurat tatimore, dhe rregullat e etikës në administratën publike.

**I. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

1. Kërkesë me shkrim për të aplikuar së bashku me numra dhe adresa kontakti;
2. Një kopje jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të kartës së identitetit;
4. Fotokopje të diplomës të të dy cikleve ose 4-vjeçarit, të noterizuar;
5. Fotokopje të certifikatave të notave, të noterizuar;
6. Fotokopje të noterizuar të certifikatës së mbrojtjes së gjuhës angleze;
7. Dëshmi penaliteti;
8. Formular vetëdeklarimi sipas Ligjit Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
9. Kopje e noterizuar e librezës së punës ku të jetë e pasqyruar eksperiencia e mëparshme;
10. Rekomandime nga punëdhënësi i fundit;
11. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit për mungesë të masave disiplinore në fuqi;
12. Platforma individuale e kandidatit për zhvillimin institucional;
13. Raport mjeko-ligjor për aftësinë për punë.
  
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Dr. Merita Isaraj**